



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.09.2019, ora 17:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 12 dhe 17 shtator 2019.
2. Miratim i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 30 shtator-18 tetor 2019
3. Njoftim për mbarimin e mandatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe hapjen e procedurave për plotësimin e vakancës.

4. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Europian-Shqipëri, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në cilësinë e vëzhgueses, në punën e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e rregullores së Këshillit (KE), nr. 168/2007”. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Adnor Shameti, Elena Xhina, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Edmond Leka, Spartak Braho, Alban Zeneli, Andi Permeti, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Ediola Braha, Nikolin Staka dhe Elda Hoti

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Damian Gjiknuri, dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Etilda Gjonaj - Ministre e Drejtësisë

Besmir Beja – Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komsionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me çështjet e rendit të ditës.

Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbaleve të datave 12 dhe 17 shtator të vitit 2019.

Procesverbalet ju kanë ardhur nëpërmjet postës elektronike.

A ka vërejtjet për procesverbalet? Nuk ka.

Kush është dakord me procesverbalet? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratoohen procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit të Ligjeve të datave 12 dhe 17 shtator 2019.

Pika e dytë e rendit të ditës është miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 30 shtator-18 tetor 2019.

A ka sugjerime nga kolegët për kalendarin e punimeve 3-javore të komisionit? Nuk ka.

E hedhim në votim.

Kush është dakord me kalendarin? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet kalendari i punimeve të Komisionit të Ligjeve për periudhën 30 shtator-18 tetor 2019.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës, te njoftimi për mbarimin e mandatit të Komisionerit për Mbrojtjen e Shërbimit Civil dhe hapjen e procedurave parlamentare për plotësimin e vakancës.

Siç jeni në dijeni, Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr.85, datë 30.10.2014, në mbështetje të ligjit nr.153/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me propozimin e jo më pak se 28 deputetëve ka zgjedhur zonjën Pranvera Strakosha në pozicionin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Bazuar në nenin 12 pika 1 e ligjit nr.153/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, zonja Pranvera Strakosha rezulton të jetë e mandatuar për një afat 5-vjeçar.

Sa më sipër, nga Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura në Kuvendin e Shqipërisë është njoftuar Komisioni i Ligjeve për të hapur procedurat për plotësimin e kësaj vakance, pasi zonjës Strakosha i mbaron mandati në datën 30 tetor të vitit 2019.

Sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 12 të ligjit nr.153/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri zgjidhet nga Kuvendi për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Procedurat për zgjedhjen e Komisionerit, sipas përcaktimeve të

pikës 1 të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, e ndryshuar, duhet të paraqiten me shkrim nga jo më pak se 28 deputetë dhe të përmbajnë një jetëshkrim të përditësuar të kandidatit dhe pëlqimin e tij për kandidimin.

Bazuar në nenin 112 pika 2 e Rregullores së Kuvendit, për paraqitjen e kandidaturave zhvillohet procedura paraprake e përzgjedhjes, siç është përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit. Kjo do të thotë se deklarohet mbarimi i mandatit të zonjës Strakosha në datën 30 tetor të vitit 2019 dhe bazuar në nenin 111, pika 2 e Rregullores së Kuvendit, Kuvendi bën njoftimin për krijimin e vakancës 45 ditë para mbarimit të mandatit, por jo më vonë se 30 ditë nga mbarimi i tij. E thënë më qartë, sipas Rregullores, publikimi i shpalljes propozohet të jetë me një afat 20-ditor nga dita e nesërme.

A jeni dakord me këtë procedurë?

Shërbimi i Monitorimit i Kuvendit ka njoftuar Komisionin e Ligjeve, sipas nenit 111 të Rregullores dhe nenit 12, pika 1 e ligjit nr.153/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, se zonjës Strakosha i mbaron mandati në datën 30 tetor 2019 dhe ne duhet të hapim procedurat për plotësimin e vakancës 45 ditë para mbarimit të mandatit, por jo më vonë se 30 ditë nga mbarimi i mandatit.

Kështu që, të nderuar kolegë, nga dita e nesërme, shërbimet e Kuvendit dhe Komisioni i Ligjeve duhet të ndërmarrin veprimet e duhura konform Rregullores për të bërë njoftimin e vakancës me afat 20 ditë.

A jeni dakord?

Miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës, pra mbarimi i mandatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe fillimi i procedurave për plotësimin e vakancës sipas ligjit “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”, dhe Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.09.2019, ora 17:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian-Shqipëri, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në cilësinë e vëzhgueses, në punën e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e rregullores së Këshillit (KE), nr. 168/2007”. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Edmond Leka, Elena Xhina, Spartak Braho, Alban Zeneli, Andi Permeti, Ediola Braha, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Nikolin Staka dhe Elda Hoti

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Damian Gjikhuri, dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Etilda Gjonaj - Ministre e Drejtësisë

Besmir Beja – Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Ulsi Manja - Kalojmë te pika e katërt e rendit të ditës, te shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi European-Shqipëri, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në cilësinë e vëzhgueses, në punën e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e rregullores së Këshillit (KE), nr. 168/2007”. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relatore është kolegja Vasilika Hysi.

Ka konfirmuar pjesëmarrjen dhe është prezente zonja Etilda Gjonaj, ministre e Drejtësisë.

Zonja Gjonaj, mirë se keni ardhur në komision!

Gjithashtu, është prezent edhe drejtori i Përgjithshëm i Kodifikimit, zoti Besmir Beja.

Zonja Ministre, do t’ju lutesha të bënit një prezantim të shkurtër të kësaj marrëveshjeje!

Pastaj do të ketë pyetje, diskutime dhe do të kalojmë në votim.

Fjala është për ju.

Etilda Gjonaj –Faleminderit, zoti kryetar!

Do t’ju bëj një shpjegim të shkurtër se çfarë përmban kjo marrëveshje dhe pse është e rëndësishme për Shqipërinë.

Në kuadër të rëndësisë së procesit të integritetit evropian është realizuar edhe marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri. Sipas kësaj marrëveshjeje Republika e Shqipërisë do të jetë në cilësinë e anëtarit vëzhgues, si pjesëmarrës në punën e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore.

Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, e quajtur ndryshe FRA, është qendra e BE-së për ekspertizën e të drejtave themelore, si një agjenci e decentralizuar e Bashkimit Evropian.

Element shumë i rëndësishëm, që duhet ta dëgjojnë të gjithë anëtarët e komisionit, është se agjencia ka si anëtarësi të gjitha vendet e Bashkimit Evropian dhe, në mos gaboj, Shqipëria është vendi i tretë që e ratifikon këtë marrëveshje, pasi është pranuar edhe nga Këshilli i Stabilizim-Asociimit i BE-së të jetë në rolin e vëzhgueses. Kjo është një gjë shumë pozitive, sidomos për faktin që ne jemi duke shpresuar për një vendim pozitiv për çeljen e negociatave dhe i jep Shqipërisë një rol shumë të rëndësishëm në këtë agjenci. Pavarësisht se kjo agjenci është e pavarur dhe e decentralizuar dhe Shqipëria është pa të dejtë vote, ajo gëzon të drejtat dhe detyrimet njësoj si të gjithë anëtarët e tjerë.

Mendoj se për Shqipërinë është privilegj të jetë anëtare pa të drejtë vote në këtë agjenci, ashtu sikurse kemi avancuar dhe kemi nxitur nënshkrimin dhe ratifikimin e të gjitha marrëveshjeve, të cilat kanë qenë për vendet anëtare të BE-së, por me proceset që ka ndërmarrë, Shqipëria është bërë anëtare vëzhguese e një sërë agjencish të tilla.

Pavarësisht se në marrëveshjen me Eurojust, që Shqipëria e ka ratifikuar, ne kemi një rol shumë të rëndësishëm, ai organizëm është vetëm për vendet anëtare të BE-së, ku Shqipëria apo ndonjë vend tjetër, si Mali i Zi, kanë kryer procedura ekstra për të qenë pjesë dhe për të përfituar nga eksperiencia dhe ekspertiza e këtyre agjencive të Bashkimit Europian.

Pjesëmarrja në këtë agjenci na jep mundësinë të shkëmbejmë praktikat më të mira për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe qenia vëzhguese në këtë agjenci i jep mundësi Shqipërisë të përshtatë më së miri legjislacionin kombëtar për të drejtat e njeriut me standardin e Bashkimit Europian.

Unë jam e bindur se të gjithë anëtarët e këtij komisioni të nderuar e dinë dhe e kanë parë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Doja vetëm t'ju vijë në dijeni....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...se në 2016-n komisioni ka miratuar propozimin që Shqipëria të jetë anëtare me status vëzhguesi në këtë agjenci.

Ministria e Punëve të Jashtme (kjo ka shumë rëndësi, sepse doni të dini cili është përfaqësuesi) ka shprehur mendimin se Ministria e Drejtësisë është institucioni më i përshtatshëm, që duhet të kryejë procedurat e anëtarësimit dhe të mbajë kontakte me Agjencinë e BE-së për të Drejtat Themelore, si institucioni lider për kapitullin 23 dhe përafrimin e legjislacionit.

Një ndër pyetjet e anëtarëve ishte: “Sa i kushton Shqipërisë ky ratifikim?” Po, është e vërtetë që është 160 mijë euro në vit, por e rëndësishme është që 80% paguhet me kontributet e projekteve IPA dhe vetëm 20% do të paguhet nga buxheti i shtetit, të cilat ne i kemi planifikuar edhe në PBA për 3- vjeçarën e ardhshme.

Pavarësisht se ka një kosto për buxhetin e shtetit, mendoj se kontributi dhe gjithë vlera që do të marrë fakti i të qenit vëzhgues në këtë agjenci, është shumë herë më e madhe se ajo që paguan buxheti i shtetit në terma financiarë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zonja Gjonaj!

Do t'ia kaloj fjalën relatores, koleges Hysi. Më pas do të vazhdojmë me pyetje dhe diskutime.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre!

Ju ndoqëm me vëmendje.

Të nderuar kolegë, kjo është një marrëveshje për të cilën ne jemi komision përgjegjës. Ju e dini që kjo marrëveshje është diskutuar, shqyrtuar dhe kanë ardhur mendime edhe nga Komisioni për Politikën e Jashtme.

Do të doja të theksoja që është pozitiv fakti që ish-ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, zoti Bushati, vuri në lëvizje dhe i kërkoi Komitetit të Stabilizim-Asociimit që Shqipëria të ishte në rolin e vëzhguese pranë Agjencisë së Bashkimit European për të Drejtat Themelore ose siç njihet ndryshe FRA, që është shumë e rëndësishme.

Pa dashur të përmend rolin që ka kjo agjenci, besoj se për Shqipërinë do të jetë pozitive, jo vetëm për faktin që agjencia operon në 10 fusha të rëndësishme, që kanë sensibilitet dhe rëndësi për Shqipërinë, siç janë: qasja në drejtësi, azili, migracioni, kufijtë, krimet e urrejtjes, personat me aftësi të kufizuara, racizmi, të drejtat e fëmijëve, romët, barazia gjinore, shoqëria e informacionit, mbrojtja e të dhënave personale, LGBT-të e të tjerë. Pra, janë një pjesë e çështjeve që kanë të bëjnë me kapitullin 23 dhe 24, për të cilat ne presim të hapen negociatat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për këtë agjenci, që njihet ndryshe FRA, dua të theksoj se lëshon opinione dhe përfundime për institucionet e BE-së, nëse legjislacioni i tyre është në përputhje me standardet. Besoj se kjo do të jetë një përvojë shumë e mirë për ne.

Kam dy pyetje për ministren e Drejtësisë, për një saktësim, pasi lexuam me vëmendje vendimin e këshillit dhe në nenin 4 të vendimit të tij thuhet se Shqipëria përcakton personat që përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin 12 të rregullores nr.168/ 2007 të këshillit. Ne do të përcaktojmë përkatësisht vëzhgues dhe vëzhgues zëvendësues, pra bëhet fjalë për dy persona.

Nga ana tjetër, në pikën 2 të nenit 4 të vendimit të këshillit thuhet se Shqipëria emëron edhe një zyrtar qeveritar, si zyrtarin kombëtar ndërlidhës, që përmendet në nenin 8 të kësaj Rregulloreje.

Me fjalë që tjera, pyetja qëndron në mënyrën si është formuluar në projekt marrëveshjen që ka ardhur, pikërisht në nenin 2, ku thuhet që përfaqësuesi i Republikës së Shqipërisë në bordin drejtues të agjencisë emërohet nga ministri i Drejtësisë. Fjala është për përfaqësuesin vëzhgues zëvendësues apo te përfaqësuesi ju keni parasysh edhe zyrtarin qeveritar si zyrtar kombëtar ndërlidhës? E theksojmë këtë, sepse në projektligjin që keni sjellë ju adresoni vetëm

përfaqësuesin në bordin drejtues të kësaj agjencie. Padyshim që ky përfaqësues, që do të jetë përfaqësues dhe vëzhguesi zëvendësues, duhet të përmbushë kriteret e parashikuara në nenin 12, paragrafi i parë.

E dyta, për sa i përket zyrtarit qeveritar, kush do të shërbejë si zyrtar kombëtar ndërlidhës dhe a mendoni që duhet të gjej rregullim në projektligj apo është ndonjë dokument tjetër?

Faleminderit!

Etilda Gjonaj – Zonja Hysi, faleminderit për pyetjen!

Janë një sërë elementesh, që, në fakt, edhe sot në diskutimet që kemi pasur në Komisionin për Politikën e Jashtme është kërkuar dhe sjellë në vëmendje nëse do të duhet të bëhet një plan veprimi për zbatimin dhe ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. Në fakt, të gjitha këto procedura edhe për ne janë të reja.

Nga ana tjetër, ...

Vasilika Hysi – Me këtë ligj ne do të zgjedhim vetëm përfaqësuesit në bord apo edhe ...?

Etilda Gjonaj – Ne zgjedhim përfaqësuesin në bordin drejtues të agjencisë së Bashkimit Europian.

Vasilika Hysi – Domethënë, vëzhgues dhe zëvendësues. Dy persona.

Etilda Gjonaj – Po, vëzhgues dhe zëvendësues.

Padyshim që respektohet Rregullorja e agjencisë e vitit 2007.

Ulsi Manja – Dakord. Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Vasilika Hysi – Për sa i përket pyetjes së dytë, kush do të jetë zyrtari qeveritar ndërlidhës.

Etilda Gjonaj - Është Ministria e Drejtësisë, sepse ...

Vasilika Hysi – Ka nevojë të rregullohet në projektligj?

Etilda Gjonaj – Nuk shikojmë se ka nevojë për rregullim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Merre fjalën dhe bëj pyetje.

Alban Zeneli - Pyetje është edhe kjo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Etilda Gjonaj – Me sa ne kemi parë, nuk është nevoja të saktësohet si një dispozitë specifike për këtë çështje. Mjafton që ne, të paktën, të kemi të përcaktuar kush do të caktojë anëtarin e bordit drejtues dhe zëvendësuesin përkatës, vëzhguesin dhe, nga ana tjetër, në projektligj thuhet se emërohet nga ministri i Drejtësisë. Është kërkesë dhe praktikë e të

gjitha shteteve anëtare, të cilat janë vëzhguese në FRA, por njëkohësisht edhe ato që janë anëtare të përhershme.

Për më tepër, Ministria e Drejtësisë ka në përgjegjësi disa nga fushat kryesore që merren me të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe një ndër kapitujt më të rëndësishëm, që hapet i pari dhe mbyllet i fundit, që është kapitulli 23. Kjo platformë dhe kjo agjenci do të shërbejnë edhe për të shkëmbyer eksperiencat për kapitullin 23 dhe përafrimin e legjislacionit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Ministre!

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, kur të jemi në votimin nën për nën, aty ku relatorja propozon ndërhyrje të teknikës legislative, propozojeni.

Mbaruat me pyetjet?

Vasilika Hysi – Mbarova.

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Zeneli për ...!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Opozita e ka integrimin, zoti Zeneli.

Vasilika Hysi – Të nderuar kolegë, për ta mbyllur relatimin dhe për të bërë propozimin përkatës, dua t'ju them se ky është pozicion shumë i rëndësishëm. Kriteret, meqenëse ka merak zoti Zeneli, që duhet të përmbushin vëzhguesi dhe vëzhguesi zëvendësues janë të përcaktuara në Rregulloren e kësaj agjencie, konkretisht në nenin 12, paragrafi 1, të jenë personalitete me njohuri në të gjitha fushat që mbulon FRA-ja, të pavarur, mund të jenë përfaqësues nga shoqëria civile, mund të jenë përfaqësues nga agjenci shtetërore, mund të jenë nga sektori privat, por jo njerëz politikë.

Të nderuar kolegë, unë dëshiroj ta miratojmë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash”, duke i sugjeruar ministres së Drejtësisë, në procesin që do të hapet për përzgjedhjen e kandidatëve, qoftë për vëzhgues, qoftë për vëzhgues zëvendësues, të zgjidhen personat më të mirë, të cilët do të dinë të marrin nga përvoja e FRA-së, pasi niveli i kësaj agjencie, unë e njoh mirë, është niveli më i lartë i mundshëm në ekspertizë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Po, zoti Braho.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Spartak Braho – Unë jam kundër. Ne jemi para faktit që ratifikojmë një marrëveshje. Çfarë janë këto shtesa? Kam 22 vjet në parlament dhe nuk ka ndodhur që ne të bëjmë shtesa në ratifikime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – I thashë, kur të bëjmë përzgjedhjen ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Zeneli.

Alban Zeneli – Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe si përfaqësues i opozitës këtu, jam dakord me zonjën Hysi që të ratifikohet kjo marrëveshje, por me sugjerimet e zonjës Hysi.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Nuk ka.

Diskutime?

Nuk ka.

Atëherë, kalojmë në votimin në parim.

Kush është dakord në parim me këtë projektligj? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim marrëveshja me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizimit të Bashkimit Europian, Shqipëri, “Për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë, me cilësinë e vëzhgueses, në punën e Agjencisë së Bashkimit Europian për të Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e Rregullores së Këshillit, KE, nr.168/2007”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen.

Neni 1.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Alket Hyseni – Duke qenë se në tekstin e marrëveshjes parashikohet që Shqipëria cakton, së paku dy, edhe vëzhgues, edhe zëvendësvëzhgues, që nënkupton se janë dy zyrtarë, dhe pika 2 e nenit 4 thotë që Shqipëria emëron edhe një zyrtar qeverisës si zyrtar kombëtar, unë mendoj që këtë ta saktësojmë në nenin 2 duke thënë: “Përfaqësuesit e Republikës së

Shqipërisë në bordin drejtues të Agjencisë së Bashkimit European për të Drejtat Themelore, si dhe zyrtari qeveritar, emërohen nga ministri i Drejtësisë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra ta saktësojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 4 i marrëveshjes, pikat 1 dhe 2, ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Jo, ka *attach* marrëveshjen.

Alket Hyseni – Ka *attach* marrëveshjen. Ajo është specifike për Shqipërinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Ta reflektojmë te pika 2. Ta transpozojmë detyrimin te pika 2, duke saktësuar që, meqenëse ne vendosëm që Ministria e Drejtësisë do të jetë institucioni i linjës, ajo do të ketë edhe tagrin për të caktuar edhe zëvendësin së bashku me vëzhguesin, sepse janë dy persona, por edhe zyrtarin si zyrtar kombëtar ndërlidhës, i përmendur në nenin 8 të Rregullores.

Etilda Gjonaj – Kur thuhet përfaqësuesi, aty përfshihet anëtari dhe zëvendësuesi i tij, sepse e ka përcaktuar Rregullorja e agjencisë e vitit 2007. Nuk është e nevojshme ta vendosim ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Ne nuk do të bëjmë ... ligje. Mund të ndryshojë edhe Rregullorja atje

....

Etilda Gjonaj – Sot, si Kuvend, kemi ratifikuar marrëveshjen siç është, kur të ndryshojë, mbase edhe ne ...

Alket Hyseni – Kur kemi miratuar ligjin, “Përfaqësuesit tanë në organizatat ndërkombëtare”, themi “Përfaqësuesit e Republikës së Shqipërisë”. Nuk kemi thënë asnjëherë “përfaqësuesi”, sepse mund të jetë një, mund të jenë dy ose mund të ndryshojnë rregullat e brendshme. Bëjmë një ligj që i qëndron kohës. Ku qëndron problemi midis “përfaqësuesi” në “përfaqësuesit”? Mund të jetë një edhe kur themi “përfaqësuesit”. Nëse e ka Rregullorja një, do të jetë një.

Etilda Gjonaj – Ja të jap një shpjegim pse nuk duhet “përfaqësuesit”, sepse aty, në fakt, është “përfaqësuesi”. Nëse mungon përfaqësuesi, shkon anëtari zëvendësues i përfaqësuesit.

Alket Hyseni – Në konceptin e gjuhës që ne kemi përdorur në ligje, mund ta përdorim shumë mirë shumësin duke nënkuptuar njëjtesin. E kundërta nuk e nënkupton.

Nëse nesër ndryshon Rregullorja e brendshme dhe thuhet se çdo shtet anëtar duhet të ketë dy anëtarë, ne do të detyrohemi të ndryshojmë ligjin, kurse nëse e kemi në ligj nuk është nevoja fare.

Etilda Gjonaj – Zoti Hyseni, në fakt, si rregull duhet të ishte vetëm neni 1, si dhe neni 3, që thotë se ky ligj hyn në fuqi, por me qëllim që të mos sjellim ...

Alket Hyseni – Ne e kemi për të mbrojtur ministrinë. Pika 2 duhet patjetër, sepse zyrtari nuk është përcaktuar fare.

Etilda Gjonaj – Në rastin Konkret ne zbatojmë Rregulloren e Agjencisë. Nëse Rregullorja e Agjencisë nesër ndryshon, automatikisht ne do të zbatojmë atë Rregullore.

Alket Hyseni – Zonja Ministre, me gjithë respektin ...

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Ju lutem, ta shpjegoj! Ka praktika të ndryshme. Ka vende që e ka Ministria e Drejtësisë kontaktin me këtë agjenci, ka vende që e ka Avokati i Popullit, ka vende të tjera që e kanë ente të tjera shtetërore. Ne po përcaktojmë ministrinë si ent dhe unë mendoj se është gjetur zgjidhje e drejtë. Duke qenë se ne e përcaktojmë si ent, nuk i referohemi dot më Rregullores për kompetencat, sepse kompetencat i kemi futur në ligj. E përcaktojmë edhe zyrtarin qeveritar, sepse nesër mund të ndodhë që të gjendeni ju në një pozitë se ku e gjeni kompetencën për zyrtarin, sepse këtë, në emër të qeverisë shqiptare, duhet ta kishe në ligj, por nuk e ke.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zonja Gjonaj, të merremi vesh se jemi me një ...

Ne sot ratifikojmë marrëveshjen, siç e propozoi zoti Braho, dhe bashkangjitur kësaj marrëveshjeje është një akt i nënshkruar me Bashkimin European në datën 9. 2. 2018, në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Pra, termat e referencës janë të përcaktuara qartë në marrëveshje.

Këtu thjesht mund të ishte vetëm neni 1 dhe për nenin 2 i jepet tagri Ministrisë së Drejtësisë të jetë zyrtari qeveritar që do të nënshkruajë sipas kësaj marrëveshjeje.

Etilda Gjonaj – Zoti kryetar, neni 2 u vendos për faktin se Ministria e Punëve të Jashtme ka pasur komunikim me Komisionin e Stabilizim - Asocimit, që Ministria e Drejtësisë të jetë institucioni i përshtatshëm për të bërë propozimin për vëzhguesin, anëtarin dhe për zëvendësuesin. Kjo është arsyeja pse po vendoset ...

Ulsi Manja - Nuk kemi asnjë vërejtje apo kundërshtim.

Ne mund të kishim temë diskutimi që ta ketë Kuvendi apo Ministria e Drejtësisë si pjesë e ekzekutivit, por nuk kemi probleme me këto.

Neni 2.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 votë abstenim.

Miratohet.

Neni 3.

Kush është dakord me nenin 3? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi?

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Relatorja dhe këshilltari të bëjnë gati raportin dhe, sipas afatit të përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit, të ndryshuar, t'i përcillet seancës plenare për votim.

Me votimin e kësaj marrëveshjeje e mbyllim për sot mbledhjen e Komisionit të Ligjeve. Mbledhja e radhës dhe rendi i ditës do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Shumë faleminderit, zonja Ministre dhe ditë të mbarë!

Faleminderit, kolegë!

MBYLLET MBLEDHJA